



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM

Nisur nga shqetësime të ngritura në media mbi rritjen e çmimit të plehrave kimike, bazuar në nenin 28, germa a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Autoriteti i Konkurrencës në datën 11 Mars 2021 realizoi një monitorim të tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, për evidentimin e kushteve të tregëtimit të këtyre produkteve, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.

Nga vlerësimi i informacionit të mbledhur gjatë monitorimit të kryer pranë ndërmarrjeve kryesore në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, si dhe në ambientet e Shoqatës Shqiptare të Plehrave Kimike dhe Inputeve Bujqësore “AFADA”, rezultoi se:

- Disa ndërmarrje gëzojnë të drejta ekskluzive në tregtimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve;
- Ndërmarrjet kanë realizuar importe të përbashkëta dhe kanë siguruar gjendje të produkteve në magazine duke i shitur ato me çmime shumë më të larta se kostot e blerjes së tyre;
- Në treg operojnë ndërmarrje të konsoliduara dhe me pjesë të konsiderueshme të tregut.

Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, ka element të një sjelljeje të bashkërenduar, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr 9121, datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 783 vendosi “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, ndërkohë që me vendimin nr. 784 vendosi “Marrjen e masave të përkohëshme në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore”, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg.